



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.2429/2021

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Lumni Sallauka, me bashkëpunëtoreshen profesionale Arta Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditoresh N.P.”.....”, sh.a., lagja, me seli në Prishtinë, kundër debitoresh S.G, në Dardani, “.....”, nr., në çështjen përmbartimore të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitoresh të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.28/19, të datës 11.06.2020, me datën **24.05.2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitoresh S.G nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.28/19, i datës 11.06.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.28/19, të datës 11.06.2020, ka vendosur që ta refuzojë si të pabazuar prapësimin e debitoresh S.G i ushtruar kundër urdhrorit për lejimin e përmbartimit numër P.nr.2856/19, të datës 11.12.2019, të lejuar nga Përmbartuesi Privat për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur debitori për shkak të, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, ta aprovojë ankesën e debitorit si të bazuar të debitorës S.G nga Prishtina dhe ta prish aktvendimin e goditur të shkallës së parë si dhe ta kthejë në rigjykim ose të ndryshoj aktvendimin e shkallës së parë.

Kreditorja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e debitores.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 dhe 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitores, është e **pa bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorja ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitores në bazë të dokumenteve të besueshëm, kartelës së konsumatorit - ekstraktit të verifikuar nga librat afariste, lidhur me borxhin e shërbimeve të ngrohjes në shumën prej 304.88 euro. Përmbareuesi Privat, me urdhrin përmbaremore P.nr.2856/19, të datës 11.12.2019, e ka lejuar propozimin për përmbaremore.

Debitorja me datën 30.12.2019, ka ushtruar prapësim, ndërsa kreditorja ka ushtruar përgjigje në prapësim. Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të prapësimin me aktvendimin PPP.nr.28/19, të datës 11.06.2020, ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin tjetër PPP.nr.28/19, të datës 29.12.2020 në pikën I të dispozitivit e ka caktuar garancinë në të holla, në shumën prej 304.88 euro, si parakusht për ankesën e ushtruar parashtruar kundër aktvendimit PPP.nr.28/19, të datës 11.06.2020, me të cilën është refuzuar prapësimi i debitorit, me pikën II ka urdhëruar debitories S.G me adrese në Dardani, nr. , që si parakusht për parashtrimin e ankesës të deponoj në llogari të veçantë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 304.00 euro, në afat prej tre (3) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ndërsa në pikën III ka vendosur që nëse debitorit nuk e deponon garancinë brenda afatit si në pikën dy të dispozitivit do të konsiderohet se ankesa nuk është dorëzuar fare.

Debitorja e ka bërë pagesën e garancionit sipas aktvendimit të lartpërmendur, kjo dëshmohet edhe me urdhërpaguesën e datës 15.01.2021.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par.2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbaremore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitores dhe e ka lënë në fuqi aktvendimin mbi lejimin e përmbaremit.

Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se ekstrakti nga librat afariste të kreditores, në bazë të cilit organi përbarues ka caktuar përbarimin, është dokument përbarues, ku kjo parashihet në nenin 29 par.1 të LPP, e ku ceket se *“përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij Ligji është: 1.1. kambialet dhe çeket me potest dhe faturë kthyesë, po qe se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2 Ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3 Faturat”*, dhe përmban bazën juridike për caktimin e përbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 par.1 dhe 27 par.1 të po këtij ligji, sipas të cilit parashihet se *“dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, andaj pretendimet ankimore të debitores se ka shkelje të dispozitave ligjore me rastin e lejimit të përbarimit, në rastin konkret nuk qëndrojnë, në ndërkohë që nuk ka prova të reja se kërkesa në bazë të dokumentit të besueshëm është përmbushur, ndërsa dokumenti përbarues është në origjinal, ashtu siç përcaktohet me nenin 40 par.1 dhe 1.3 të LPP, andaj nga kjo rezulton se dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim dhe se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar prapësimin e debitores si të pabazuar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, si faktin që debitorja nuk ka qene shfrytëzuese e shërbimeve të kreditores në periudhën për të cilën është ushtruar propozimi për përbarim, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi *(të njëjtat pretendime mund të parashtrohen në procedurë kontestimore, nëse eventualisht e njëjta inicohet)*.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përbarimore *“në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (b) të LPK, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2429/2021, datë 24.05.2022

Gjyqtari,
Lumni Sallauka